UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" | UNIVERSITETI I PRIZRENIT "UKSHIN HOTI" | UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" | UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË

Universiteti University FEHMI AGANI GJAKOVË | UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA FERIZAJ

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
REKTORATI
Pranuar me dt. 27.09.2021

| Njësia orga | Num | Nr.Ekzem | Vlera |
|---|---|---|---|
| | 1644 | | |

| | |
|---|---|
| **PËR:** | - **Znj. Arbërije Nagavci, ministre e MASHTI** |
| **CC:** | - **Z. Burim Gashi, drejtor i departamentit për arsim të lartë i MASHTI**<br>- **Z. Naser Sahiti, rektor i UP – së'**<br>- **Z. Samedin Krrabaj, rektor i UPZ**<br>- **Z. Fadil Millaku, rektor i UHZ**<br>- **Z. Bajram Kosumi, rektor i UKZ**<br>- **Z. Artan Nimani, rektor iUFAGJ**<br>- **Z. Agron Bajraktari, rektor i USHAF** |
| **PËRMES:** | |
| **NGA:** | - **Z. Alush Musaj, rektor i UIBM – kryesues i Konferencës së Rektorëve të Universiteteve Publike** |
| **TEMA:** | - **Kërkesë për lejimin e afateve shtesë për regjistrim dhe vendosjen e të dhënave në SMIAL (neni 7) dhe afatet për raportim të listave të studentëve nga shtojca 1 e SMIAL (neni 8), të UA (MASHT) nr. 13/2018 për sistemin e menaxhimit të informatave në arsimin e lartë** |

E nderuar ministre, znj. Nagavci,

Në pajtim me Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr. 13/2018 PËR SISTEMIN E MENAXHIMIT TË INFORMATAVE NË ARSIMIN E LARTË, neni 7 dhe 8:

Ju drejtohemi me kërkesë, që për Universitetet Publike

- Të mundësoni afate shtesë për regjistrim dhe vendosjen e të dhënave në SMIAL, të përcaktuara me nenin 7 të UA (MASHT) Nr. 13/2018.
- Gjithashtu, të mundësoni afate shtesë edhe për raportimin e listave të studentëve nga shtojca 1 e SMIAL, të përcaktuara me nenin 8 të UA (MASHT) Nr. 13/2018.

Si pasojë e situatës të krijuar me Pandeminë COVID 19 dhe vendimeve të Qeverisë për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, universitetet publike janë detyruar që të pezullojnë të gjitha aktivitetet mësimore deri më 27 shtator 2021 (afatin e provimeve të shtatorit si dhe afatet e provimeve pranuese për pranimin e studentëve të rinj, për shkak të situatë me pandeminë janë shfaqur vështirësi edhe në afatet e transferimit të studentëve).
Pezullimi i aktiviteteve mësimore ka bërë të pamundur që universitetet të arrijnë ti realizojnë proceset në afatet e përcaktuara me SMIAL.

**E nderuar ministre, znj. Nagavci, gjeni mundësinë, që në pajtim me situatën e krijuar me pandeminë COVID-19 të lejoni afate shtesë sipas kërkesës. Marr parasysh që pezullimi i aktiviteteve mësimore ka zgjatë 14 ditë, është kërkesë e universiteteve që të gjitha afatet e parapara me nenin 7 dhe 8 të UA (MASHT) Nr. 13/2018, të shtyhen për 14 ditë.**

Faleminderit ne mirëkuptim,

Me respekt,